



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE  
DREJTORIA PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

Nr. 720/1 prot.

Tiranë më 17.6.2020

Lënda: Kthim përgjigje lidhur me kërkesën për dhënie mendimi

**Z. ARDI VELIU**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM I POLICISË SË SHTETIT**

**Tiranë**

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale u njoh me kërkesën tuaj, nr. 3704 Prot, datë 15.06.2020, nëpërmjet të cilës kërkohet dhënie mendimi në lidhje me marrjen e të dhënave biometrike të shtetasve shqiptarë nga shoqëria koncesionere Sagem Securite.

Referuar kërkesës suaj, në bazë të pikës 3.1.1 të nenit 3 (*Dhënia e koncesionit*) të kontratës së koncesionit "*Për prodhimin dhe shpërndarjen e kartave të identitetit dhe pasaportave elektronike*" (në vijim "*Kontrata*"), nënshkruar ndërmjet Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë (referuar si "*Autoriteti*") dhe grupit të shoqërive me ortakë Sagem Securite dhe Fondi Shqiptaro-Amerikan i Ndërmarrjeve (referuar si "*Koncesioneri*"), konstatohet se "*[...] Autoriteti jep dhe autorizon Koncesionerin të zbatojë shërbimet e hartimit, përcaktimit, zhvillimit, zbatimit dhe operimit të sistemit, për furnizimin me dokumenta identifikimi të shtetasve dhe/ose rezidentëve të Republikës së Shqipërisë*".

Me tej, Zyra e Komisionerit vëren, ndër të tjera, se në bazë të nenit 37 (*Mbrojtja e të dhënave personale*) të Kontratës, Autoriteti është pronar dhe kontrollues i të dhënave personale dhe Koncesioneri përpunon të dhënat në emër të Autoritetit.

Nëpërmjet parashikimeve kontraktore të sipërpërmendura, evidentohen qartë cilësitë e palëve nënshkruese në lidhje me përpunimin e të dhënave personale, ku Autoriteti (Ministria e Brendshme) gëzon cilësinë e "kontrolluesit", ndërsa Koncesioneri atë të "përpunuesit" të të dhënave personale.

Rrjedhimisht, vlerësojmë se, bazuar në nenin 3 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, “kontrollues” i të dhënave personale të shtetasve shqiptarë, të përpunuara në kuadër të Kontratës, është Autoriteti (Ministria e Brendshme), ndërsa “përpunues” i këtyre të dhënave është Koncesioneri.

Sa më sipër, sqarojmë se për çdo kërkesë që lidhet me përpunimin e të dhënave personale, zbatimin e Kontratës dhe marrëdhënien me Koncesionerin, legjitimohet vetëm Autoriteti (Ministria e Brendshme) në cilësinë e kontrolluesit, jo institucionet në varësi të saj.

Në çdo rast, Ministria e Brendshme, në cilësinë e kontrolluesit gëzon të gjitha të drejtat që i njeh ligji nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, si dhe legjislacioni i saj material, lidhur me përpunimin e mëtejshëm (përfshirë ndër të tjera, ruajtjen, transmetimin, etj.) të të dhënave personale të përfutuara në bazë të Kontratës.

Në këtë kuadër, vlerësojmë se Ministria e Brendshme legjitimohet të aksesojë, në çdo moment, çdo kategori të dhënash personale që përpunohen nga ana e përpunuesit (Koncesionerit) në kuadër të objektit të Kontratës, duke përfshirë edhe të dhënat biometrike (gjurmët e gishtave) të shtetasve që kanë aplikuar për t’u pajisur me letërnjoftim dhe/ose pasaportë, të cilat janë përpunuar, në sistemin përkatës, nga Koncesioneri.

Nga ana tjetër, është rëndësishme që çdo kërkesë për akses, si dhe çdo veprim tjetër me të dhënat personale, të kryhet në kushte optimale sigurie dhe konfidencialiteti, duke evidentuar dhe regjistruar çdo veprim në një regjistër për qëllime provueshmërie dhe sigurie, në përputhje me dispozitat e nenit 27 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar.

Sa i përket mundësisë së aksesimit të të dhënave personale që përpunohen në bazë të Kontratës, nga Policia e Shtetit (për qëllime të ligjshme policore), Zyra e Komisionerit gjykon se legjitimimi i një kërkesë të tillë duhet të vlerësohet dhe adresohet nga kontrolluesi (Ministria e Brendshme), ndër të tjera, në përputhje me parashikimet e neneve 124 dhe vijues ligjit nr. 108/2014 “Për policinë e shtetit” i ndryshuar, si dhe në respektim të plotë të parashikimeve të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI  
Besnik Dervishi

